

Shtojca nr.4

KRITERET PËR PËRFSHIRJEN E INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NË PROGRAMIN "PAS SHKOLLE"

Përfshirja e institucioneve publike të arsimit parauniversitar në Programin "Pas Shkolle" realizohet mbi bazën e kritereve të miratuara nga Ministria e Arsimit. Përmbushja e këtyre kritereve vlerësohet nga Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar gjatë procesit të përzgjedhjes së institucioneve arsimore, me qëllim garantimin e kushteve të nevojshme për organizimin dhe zhvillimin e Programit "Pas Shkolle".

Institucionet arsimore që aplikojnë për t'u përfshirë në Programin "Pas Shkolle" duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë dokument.

Kriteret prioritizuese nuk janë kushte detyruese, por përdoren për renditjen e institucioneve që i kanë plotësuar kriteret e detyrueshme.

A) KRITERE TË DETYRUESHME

Institucioni arsimor parauniversitar duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

1. **Numri i nxënësve.** Institucioni arsimor ka një numër të mjaftueshëm nxënësish për të garantuar organizimin efektiv të grupeve dhe klubeve të Programit "Pas Shkolle", sipas programit të miratuar.
2. **Nevoja për zbatimin e programit "Pas Shkolle".** Institucioni arsimor argumenton nevojën për zhvillimin e Programit "Pas Shkolle", bazuar në nevojat e nxënësve për mbështetje shtesë në të nxënë, interesin e tyre për veprimtari jashtë orarit mësimor të detyruar, kërkesat e prindërve, si dhe nevojën për të mbështetur zhvillimin social, emocional dhe krijues të nxënësve.
3. **Infrastruktura dhe mjediset.** Institucioni arsimor disponon klasa dhe mjedise funksionale për zhvillimin e aktiviteteve të Programit "Pas Shkolle", në përputhje me standardet e sigurisë dhe organizimit.
Në rastin e shkollave që zhvillojnë mësimin me dy turne ose që janë shkolla pritëse (shkolla që akomodojnë nxënës të shkollave në proces rikonstruksioni), programi organizohet nëse garantohen mjedise të veçanta ose një organizim i orarit që nuk cenon zhvillimin normal të procesit mësimor.
4. **Gjendja e objektit.** Institucioni arsimor nuk është në proces rikonstruksioni ose në kushte që pengojnë zhvillimin normal të Programit "Pas Shkolle".
5. **Bashkëpunimi me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore.** Institucioni arsimor demonstroi mbështetjen e prindërve për zhvillimin e Programit "Pas Shkolle" dhe interesin për pjesëmarrjen e nxënësve në aktivitetet e tij.
6. **Kapacitetet organizative.** Institucioni arsimor disponon strukturat drejtuese dhe kapacitetet organizative të nevojshme për organizimin, koordinimin dhe monitorimin e Programit "Pas Shkolle".
7. **Kapaciteti për zhvillimin e aktiviteteve.** Institucioni arsimor provon se garanton kushtet organizative dhe infrastrukturore për zhvillimin e grupeve të mbështetjes për të nxënë dhe

të klubeve të parashikuara nga Programi "Pas Shkolle", në përputhje me interesat e nxënësve.

8. ***Siguria, mbrojtja dhe mirëqenia.*** Institucioni arsimor garanton kushtet e nevojshme për mbrojtjen, sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve gjatë organizimit dhe zhvillimit të Programit "Pas Shkolle", në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e funksionimit të institucionit arsimor.

B) KRITERE PRIORITIZUESE

Përparësi në procesin e përzgjedhjes kanë institucionet publike të arsimit parauniversitar që:

- a) zhvillojnë mësimin me një turn;
- b) kanë numër më të madh nxënësish përfitues;
- c) kanë përvojë në organizimin e mbështetjes për të nxënit, ngritjes së klubeve, zhvillimit të veprimtarive jashtë orarit mësimor të detyruar dhe projekteve edukative;
- d) bashkëpunojnë me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, komunitetin, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe partnerë të tjerë social;
- e) ofrojnë mjedise/shërbime mbështetëse për nxënësit, si transport, mensë ose ambiente për ushqim.